

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9643, DATË 20.11.2006, “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Në kuadër të luftës pa kompromis ndaj krimit të organizuar, ky projektligj është hartuar me qëllim e vetëm të mospërfitimit të fondeve publike jo vetëm nga operatorët të cilët janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të cituara në nenin 1 të këtij projektligji, por edhe në rastet kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve, por miratimi i tij vjen si një domosdoshmëri për trajtimin e fenomeneve shumë problematike të hasura në praktikë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në bazë të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, çdo operator ekonomik që synon të fitojë kontrata publike dhe rrjedhimisht dhe fonde publike, duhet të plotësojë paraprakisht disa kushte të cilat ndahen në kushte ligjore, ekonomiko-financiare dhe teknike. Nëse kushtet ekonomiko-financiare dhe kushtet teknike, synojnë të sigurojnë që subjekti fitues i kontratës publike është i aftë ta zbatojë atë, kushtet ligjore, synojnë të sigurojnë që kontrata publike po lidhet me një subjekt privat që funksionon në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në vend, si dhe ka integritet, profesionalizëm dhe përgjegjshmëri.

Në këtë frymë është dhe neni 45, në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik në fuqi”, të ndryshuar. Në këtë nen, ndër të tjera, parashikohet dhe ndalimi i dhënies së kontratave publike, operatorëve

ekonomikë, të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për një listë veprash penale.

Duke pasur në konsideratë ndjeshmërinë e qeverisë për të luftuar kriminalitetin në vend, duke shmangur në çdo rast dhe me çdo mjet dhënien e kontratave publike dhe fondeve publike, operatorëve ekonomikë të dënuar penalisht, u mor në analizë parashikimi aktual në ligjin për prokurimin publik duke u vlerësuar dhe në mënyrë krahasimore me parashikimin respektiv në direktivën përkatëse të BE-së. Nga analiza rezultoi se parashikimi ligjor aktual nuk ezauron edhe rastet kur një përfaqësues i operatorit ekonomik aksionar, ortak, administrator, përfaqësues ligjor etj., është i dënuar me vendim të formës së prerë, si dhe në listën e veprave penale të parashikuara, vlerësohet e nevojshme të shtohen dhe disa vepra të tjera. Ky amendim vjen edhe më shumë në përputhje me nenin respektiv të direktivës përkatëse të BE-së.

Një parashikim i tillë më i zgjeruar dhe më gjithëpërfshirës, ku përjashtohet nga mundësia për të fituar një kontratë publike jo vetëm operatori ekonomik që ka një dënim penal si subjekt juridik, por edhe kur individët përfaqësues të subjektit kanë një dënim të tillë, do të shmangë çdo mundësi që operatorë ekonomikë që kanë një dënim penal si persona juridikë, apo të përfaqësuar nga individë të dënuar penalisht të fitojnë kontrata publike.

Ky rregullim i posaçëm do ta bëjë jo vetëm më serioze, por edhe më konkrete luftën me të gjitha mënyrat kundër krimit në Shqipëri.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Shqipëria, në përputhje me angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), miratuar me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”, duhet të bëjë përafrimin e plotë të legjislacionit dhe si i tillë ky projektligj ka si qëllim përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis*, duke realizuar kështu përmirësimin e kuadrit rregullator për prokurimet publike.

Projektligji përafron direktivën nr.2014/24, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për prokurimin publik”, (CELEX-32014L0024) konkretisht,

paragrafin 1, të nenit 57, të kësaj direktive, sa i takon kriterëve për skualifikimin e operatorëve ekonomikë nga një procedurë prokurimi.

Për këtë, në nenin 45 të ligjit është bërë riformulimi i paragrafit 1 të tij, për të identifikuar qartësisht rastet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë, si pasojë e dënimit penal të marrë prej tyre, përfaqësuesve ligjorë, aksionarëve, ortakëve apo anëtarëve të organeve administrative, drejtuese apo mbikëqyrëse të tyre për një nga veprat penale të listuara që lidhen me krimin e organizuar, terrorizmin apo edhe korrupsionin.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 45 “Kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve”, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, kur ka të dhëna se është ose ka qenë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për ndonjë nga veprat e mëposhtme:

- a) Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;
- b) Korrupsion;
- c) Mashtrim;
- ç) Pastrim parash ose financim i terrorizmit;
- d) Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste;
- dh) Organizimi, drejtimi ose financimi i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
- e) Falsifikim;
- ë) Puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij.

2. Paragrafi i parë i pikës 3 ndryshohet, si më poshtë:

Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin, si më poshtë:

- a) Vërtetim nga dosja gjyqësore ose një dokument të njëvlefshëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrative që vërteton kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronja “a”, “b” dhe “c”.

3. Kudo ku përmend, në titullin dhe përmbajtjen e këtij neni, fjalët “...kandidatë ose ofertues ...”, zëvendësohen me “... operator ekonomik ...”.

Riformulimi i kësaj pike të nenit 45, të ligjit për prokurimin publik është orientuar në tre drejtime kryesore:

- a) Ndalimin e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike, në rastin kur çdo operator ekonomik është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale që përmenden në këtë pikë të nenit.
- b) Shtimin e veprave penale në këtë pikë të nenit 45, si raste skualifikimi nga procedurat e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike. Vepra penale si:
- pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, bandë e armatosur, organizatë terroriste;
 - financim i terrorizmit;
 - vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste;
 - organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe i shitjes së narkotikëve, si dhe veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
 - puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.
- c) Detyrimi për të skualifikuar nga përzgjedhja e fituesve të kontratave publike shtrihet jo vetëm ndaj një operatori ekonomik të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale, siç parashikohej në dispozitën aktuale, por tashmë edhe kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, aksionar ose ortak, i operatorit ekonomik ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore në vend.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri.

Projektligji është bashkërenduar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE